



# **GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E FAMILJEVE NE SHQIPERI**

**Gjashtëmujori i parë, 2022**

**BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

**Korrik, 2022**

## PERMBAJTJA

1 -Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar.....	4
2- Huamarrja e familjeve .....	6
3- Ngarkesa në borxh e familjeve.....	10
4- Pasuria e familjeve .....	12

## Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Familjeve

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet që prej vitit 2010, me frekuencë gjashtëmujore. Ky vrojtım është hedhur në terren në maj 2022 dhe mbulon zhvillimet mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve për gjashtëmujorin e parë 2021, si edhe pritshmëritë e tyre për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022. Ai është kryer mbi një kampion rastësor prej 1210 familje, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin.

### ▪ GJENDJA FINANCIARE

Numri total i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë. Në terma vjetorë, rënia ka ardhur nga sektori privat dhe ai shtetëror, ndërkohë që numri i të vetëpunësuarve ka rezultuar në rritje. Niveli i përgjithshëm i të ardhurave të familjeve ka shënuar rënie gjatë periudhës, ndërsa niveli i përgjithshëm i shpenzimeve të jetesës ka rezultuar në rritje në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë.

### ▪ HUAMARRJA

Rreth 22% e familjeve të përgjigjura (ose 240 familje), deklarojnë se kanë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje. Kjo peshë ka rezultuar në rënie me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 2 pp krahasuar me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 27%. *Totali i tepricës së raportuar të huasë në kampionin e vrojtuar, ka rezultuar në rritje krahasuar me vrojtımın e kaluar, por më e vogël se një vit më parë.* Rreth 66% e tepricës është siguruar nga 'burime formale' ('bankat' dhe 'IFJB) dhe 21% nga 'burime joformale' ('persona fizikë' dhe 'hua në formë malli'). Në terma gjashtëmujorë, kjo strukturë është zhvendosur në favor të huamarrjes nga burime joformale, por në trema vjetorë rezulton e zhvendosur drejt huasë formale, si rezultat i rritjes së vlerës së huamarrjes nga bankat. Sipas qëllimit të përdorimit të huasë, rezulton se rreth 41% e saj është përdorur për 'blerjen/riparimin e një prone'; 12% për 'zhvillimin e një biznesi'; 9% për qëllime 'konsumi'; dhe 39% për 'qëllime të tjera' (ku mbizotëron huamarrja për 'studime' dhe huamarrja ' për të mbuluar shpenzimet shëndetësore'). Pesha e huamarrjes për blerjen/riparimin e një prone ka shënuar rritje të ndjeshme si në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë.

### ▪ NGARKESA NË BORXH

Rreth 76% e familjeve huamarrëse të përgjigjura deklarojnë që kësti i huasë nuk ka ndryshuar gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar. Balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për një prirje të lehtë rënëse të këstit gjatë periudhës. Rreth 51% e familjeve huamarrëse deklarojnë se aftësia e tyre paguese nuk ka ndryshuar gjatë periudhës së vrojtuar, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon përmirësim të aftësisë paguese gjatë periudhës. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022, rreth 61% e familjeve nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për pritje optimiste. *Indeksi i marrjes/rimarrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm ka mbetur pothuaj në të njëjtin nivel krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, gjë që mund të sinjalizojë një moderim të kërkesës së individëve për financim në gjysmën e dytë të vitit 2022.*

### ▪ PASURIA E FAMILJEVE

Rreth 93% e familjeve (total i kampionit të intervistuar) 'zotërojnë 1-2 prona të patundshme', kryesisht shtëpi banimi; 2% deklarojnë se 'zotërojnë më shumë se 2 prona të patundshme', (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.) dhe 5% kanë deklaruar se 'nuk zotërojnë asnjë pronë'. Në grupin e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare, rezulton se depozitat dhe/ose llogaritë bankare vijnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të familjeve (56% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (51% e rasteve). Krahasuar me 6-mujorin e kaluar, këto pesha kanë rezultuar në rënie me 4 pp në rastin e totalit të kampionit, dhe me 14 pp në rastin e familjeve huamarrëse.


# 1 -Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar

**Karakteristikat e kampionit.** Vrojtimi i radhës është kryer mbi kampionin rastësor prej 1210 familje, ku rreth 90% e tyre (1083 familje) kanë marrë pjesë në procesin e intervistimit duke ju përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Pësia e të përgjigurve ndaj totalit të kampionit ka mbetur e pandryshuar krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me një vit më parë. Në totalin e familjeve të përgjigjura, rezulton se rreth 50% e tyre banojnë në zonat urbane dhe 50% në zonat rurale të vendit.

Analiza në vijim i referohet vetëm familjeve që kanë dhënë përgjigje për secilën pyetje dhe të gjitha llogaritjet janë bërë mbi bazën e totalit të të përgjigurve.

**1.1-Punësimi dhe burime të tjera të ardhurash.** Numri total i anëtarëve të familjeve që sigurojnë të ardhura nga punësimi/vetëpunësimi në sektor shtetëror, privat dhe/ose burime të tjera<sup>1</sup>, ka shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (me 1.3 %) dhe rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë (me 0.6%), më e theksuar në rastin e të vetëpunësuarve dhe emigrantëve.

**Grafik 1.1 Shpërndarja e personave që sigurojnë të ardhura sipas llojit të burimit.**  
(në% ndaj totalit të personave që sigurojnë të ardhura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zëri 'Tjetër' përmbledh kryesisht rastet e personave që marrin asistencë invaliditeti, ndihmë nga të afërm dhe ata që bëjnë punë të rastit.

Duke e fokusuar analizën vetëm në pjesën e të punësuarve<sup>2</sup> të kampionit të vrojtuar (Tabelë 1.1), numri total i tyre gjithashtu ka shënuar rënie me 3.5% në terma gjashtëmujorë dhe me 1.4% në terma vjetorë. Në terma vjetorë, rënia ka ardhur nga sektori privat (me 4.6%) dhe ai shtetëror (me 2.9%), ndërkohë që pjesa e të vetëpunësuarve ka shënuar rritje me 3.5%.

<sup>1</sup>Në pyetësor, përveç punësimit në sektor shtetëror dhe privat, si burime të ardhurash listohen dhe: 'pensioni', 'asistencë sociale për papunësi', 'emigracioni' dhe zëri 'tjetër', ku përfshihet çdo lloj burimi tjetër që nuk është marrë parasysh në alternativat e dhëna.

<sup>2</sup>Këtu janë përfshirë vetëm të punësuarit në sektorët shtetëror, privat (bujqësor dhe jobujqësor) dhe të vetëpunësuar (në sektor bujqësor dhe jobujqësor).

**Tabelë 1.1 Numri i të punësuarve sipas sektorëve.**

		Shtetëror	Privat	Vetëpunësuar	Total të punësuar	Ndr. 6-mujor	Ndr. vjetor
V15	6MII_2017	317 (21%)	595 (38%)	634 (41%)	1546	-2.2%	2.1%
V16	6MI_2018	259 (17%)	592(38%)	705 (45%)	1556	0.6%	-1.5%
V17	6MII_2018	280 (18%)	618(39%)	682 (43%)	1580	1.5%	2.2%
V18	6MI_2019	266 (18%)	623 (41%)	613 (41%)	1502	-4.9%	-3.5%
V19	6MII_2019	235 (17%)	574 (41%)	606 (43%)	1415	-5.8%	-10.4%
V20	6MI_2020	233 (16%)	621 (43%)	585 (41%)	1439	1.7%	-4.2%
V21	6MII_2020	234 (16%)	578 (41%)	611 (43%)	1423	-1.1%	0.6%
V22	6MI_2021	241 (17%)	670 (46%)	532 (37%)	1443	1.4%	0.3%
V23	6MII_2021	231 (16%)	642 (44%)	602 (41%)	1475	2.2%	3.7%
V24	6MI_2022	234 (16%)	639 (45%)	550 (39%)	1423	-3.5%	-1.4%


Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar

Shënim: Shifrat në kllapa janë peshat e secilit zë në raport me totalin e të punësuarve.

Numri i familjeve që kanë deklaruar dhe **burime të tjera të qëndrueshme të ardhurash**<sup>3</sup> (si qira, interesa bankare etj.) ka rezultuar 12% (ose gjithsej 128 familje), duke shënuar një rritje të lehtë me 0.4 pp gjatë periudhës dhe me 2 pp krahasuar me një vit më parë. Në këtë grup familjesh, rreth 50 % e tyre deklarojnë si burime alternative të ardhurash 'interesat nga kursimet (depozita, bono thesari etj.)' dhe 20% deklarojnë të ardhura nga 'qiradhënia e pronave' dhe këto zëra kanë rënë respektivisht me 11 pp dhe 4pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar. Një peshë në rritje ka shënuar zëri "tjetër", ku familjet përmendin kryesisht ndihmën nga familjarë ose të afërm kryesisht në emigracion.


**1.2-Të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve.** Gjatë 6-mujorit në analizë, struktura e shpërndarjes së familjeve sipas nivelit të të ardhurave, është përqendruar drejt nivelit "50-100 mijë", si në terma gjashtëmujore dhe në terma vjetore, duke rezultuar në 31% të familjeve. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e familjeve (rreth 52% ) vijojnë të deklarojnë të ardhura mujore në nivelin "17-50 mijë lekë" dhe kjo peshë ka rënë me 23 pp si në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë. (Grafik 1.2).

**Grafik 1.2 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të të ardhurave.**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 1.3 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të shpenzimeve.**



<sup>3</sup> Në këtë pyetje, alternativat e listuara si burime të qëndrueshme të ardhurash janë: (1) qira, (2)interesa nga kursimet (depozita, bono thesari etj.), (3) interesa nga para të dhëna hua të tretëve, (4)tjetër (përcakto).

Në shpërndarjen e familjeve sipas nivelit të *shpenzimeve të domosdoshme të jetesës*, gjatë periudhës vihet re një zhvendosje drejt niveleve më të larta të shpenzimeve mujore, kryesisht drejt kategorisë “20-50 mijë lekë” dhe “50 mijë-100 mijë lekë në muaj, duke reflektuar situatën e rritjes së përgjithshme të çmimeve gjatë periudhës së vrojtuar. (Grafik 1.3).

**Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, Indeksi i të ardhurave<sup>4</sup>** ka shënuar rënie për herë të parë pas katër periudhash me rritje, ndërsa **Indeksi i shpenzimeve<sup>5</sup>** kanë vijuar prirjen rritëse të shënuar që dy vite më parë, duke rezultuar në një përkeqësim të bilancit financiar të familjeve. Kjo ecuri ka reflektuar ngërçin ekonomik në sektorë të caktuar ndikuar nga lufta në Ukrainë, si dhe rritjen e shpenzimeve të jetesës për familjet si rezultat i rritjes së përgjithshme të çmimeve në vend.

**Grafik 1.4 Indekset e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve. (2010=100)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Euroizimi i të ardhurave* të familjeve shqiptare vijon të mbetet i ulët, ku vetëm 17% e tyre (187 familje në 1083 familje të përgjigjura) deklarojnë se kanë të ardhura në valutë (kryesisht në euro) në raporte të ndryshme ndaj totalit të të ardhurave mujore<sup>6</sup>. Kjo peshë ka mbetur pothuaj e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe ka shënuar rritje me 3 pp krahasuar me një vit më parë.

## 2- Huamarrja e familjeve

Në këtë vrojtim, numri i familjeve që deklarojnë se kanë *një ose më shumë hua për të paguar* në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje, ka rezultuar në *240 familje ose rreth 22% e të përgjigjurve*. Kjo peshë ka rezultuar në rënie me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 2 pp krahasuar me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 27%. *Analiza në vijim i referohet vetëm grupit të familjeve huamarrëse<sup>7</sup>.*

<sup>4</sup> ‘Indeksi i të ardhurave’ është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientet e përcaktuar për çdo interval si në vijim: ‘deri në 17 mijë lekë’ me 0.2; ‘17-50 mijë lekë’ me 0.4; ‘50-100 mijë lekë’ me 0.6; ‘100-200 mijë lekë’ me 0.8; dhe ‘mbi 200 mijë lekë me 1’. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të të ardhurave mujore.

<sup>5</sup> ‘Indeksi i shpenzimeve’ është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: ‘deri në 10 mijë lekë’ me 0.2; ‘10-20 mijë lekë’ me 0.4; ‘20-50 mijë lekë me 0.6; ‘50-100 mijë lekë me 0.8’ dhe ‘mbi 100 mijë lekë’ me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 =100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të shpenzimeve të domosdoshme mujore.

<sup>6</sup> Alternativat e lidhur me nivelin e të ardhurave në monedha të huaj janë: (1) ‘nuk kam fare’, (2) ‘deri në 10%’, (3) ‘10-50%’ dhe (4) ‘mbi 50%’.

<sup>7</sup> Shënim metodologjik: meqë një familje mund të ketë më shumë se një hua për të paguar në periudhën referuese me karakteristika të ndryshme (burimi, qëllimi etj), për të mos humbur informacionin, në këtë rubrikë, llogaritjet janë bërë

**2.1-Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse.** Gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar, struktura e shpërndarjes së familjeve huamarrëse sipas të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara, është zhvendosur drejt niveleve më të larta krahasuar me periudhën e kaluar. Kjo ka rezultuar në rritje pothuaj në të njëjtën masë të vlerave të *indeksit të të ardhurave* dhe të *indeksit të shpenzimeve*, gjatë periudhës, por duke mbetur nën vlerat e një viti më parë.

**Grafik 2.1** Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes huamarrëse.

(2010 = 100)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.2-Qëllimi i huamarrjes.** Qëllimi kryesor i huamarrjes mbetet: 'për konsum' në 33% të rasteve të huamarrjes, 'për blerjen/riparimin e një prone' në 24% të rasteve dhe për 'zhvillim biznesi' në 16% të rasteve. Peshat e rasteve të huamarrjes 'për konsum' dhe "për blerje/riparim prone" kanë rezultuar në rënie krahasuar me 6-mujorin e kaluar (respektivisht me 2 pp dhe 1 pp) dhe krahasuar me një vit më parë (respektivisht me 3 pp dhe 2 pp). Nga ana tjetër, rastet e huamarrjes për 'zhvillim biznesi', kanë vijuar prirjen rritëse (me 4 pp në terma 6-mujore dhe me 5 pp në terma vjetore) të evidentuar që pas lehtësimit të masave të marra në kuadër të pandemisë.

**Grafik 2.2** Huamarrja sipas QËLLIMIT të përdorimit të huasë.

(në % ndaj totali të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.3-Teprica e huasë.** Duke analizuar tepricën e deklaruar sipas burimeve dhe qëllimeve të përdorimit, struktura e shpërndarjes së saj vijon të paraqitet e kundërt nga shpërndarja e rasteve të huamarrjes

mbi 'totalin e rasteve të huamarrjes' të deklaruara, përveçse kur specifikohet '...mbi totalin e huamarrësve (në këtë vrojtim = 257 familje). Me 'raste huamarrje' nënkuptojmë totalin e huave të marra nga e njëjta familje dhe më të njëjtën karakteristikë, p.sh.: një familje që deklaron 2 hua të marra nga banka përbën '1 rast huamarrje nga banka' dhe një familje që ka një hua nga banka dhe një nga një person fizik, përbën '1 rast huamarrje nga banka' dhe '1 rast huamarrje nga persona fizik'.


(frekuenca e huamarrjes). Kështu, për gjashtëmujorin në analizë, rezultojnë se rreth 66% e tepricës vjen nga burime formale (65% nga bankat dhe 1% nga IFJB-të) dhe rreth 34% nga burime joformale, pothuaj e gjitha në formën e huamarrjes nga 'persona fizikë'. Në terma gjashtëmujorë, kjo strukturë është zhvendosur me 14 pp në favor të huamarrjes nga burime joformale kundrejt asaj formale, por në terma vjetorë rezultojnë e zhvendosur me 4 pp drejt huasë formale, si rezultat i rritjes së vlerës së huamarrjes nga bankat. (Grafik 2.3).

**Grafik 2.3 Përbërja e tepricës sipas BURIMIT të huasë.** (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Burimi: Banka e Shqipërisë

**Grafik 2.4 Përbërja e tepricës sipas QËLLIMIT të huasë.** (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim. Zëri "Të tjera" përfshin kryesisht huamarrje për të përballuar shpenzime mjekësore.

Duke e analizuar tepricën e huamarrjes sipas qëllimit të përdorimit (Grafik 2.4), rezultojnë se rreth 41% e saj është përdorur për 'blerjen/riparimin e një prone', 12% për 'zhvillim biznesi', 9% për 'konsum'. Pesha e huamarrjes për blerjen apo riparimin e një prone ka shënuar rritje të ndjeshme si në terma 6-mujorë dhe në terma vjetorë (respektivisht 20 pp dhe 15 pp), ndërkohë që pesha e dy zërave të tjerë ka rezultuar në rënie gjatë periudhës. Nga ana tjetër, është rritur konsiderueshëm pesha e huamarrjes për 'qëllime të tjera', duke arritur në 39% të totalit. Në këtë grupim ka mbizotëruar huamarrja për 'studime' dhe huamarrja për mbulimin e "shpenzimeve shëndetësore".

**2.4-Format e huamarrjes.** Në rreth 34% të rasteve të raportuara, huamarrja e familjeve rezultojnë në formën e 'kredisë nga institucione financiare', ku 31% e rasteve janë në trajtë 'kredite bankare' (rritje me 4 pp krahasuar me 6MII 2021) dhe 3% janë në trajtë 'kartash krediti dhe overdraft' (rënie me 1 pp krahasuar me 6MII 2021). Në rreth 49% të rasteve, huamarrja deklarohet në formën e 'parasë në dorë' dhe në 17% të rasteve në formë 'malli të papaguar' dhe të dyja këto pesha kanë rezultuar në rënie gjatë periudhës krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës.

**Grafik 2.5 - Huamarrja sipas FORMËS së huasë.**

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.



**2.5-Pagesa e huasë.** Dy format kryesore të pagesës së huasë vijojnë të mbeten pagesat 'me shumë të njëjtë çdo 1/3/6/12 muaj' (39% e rasteve të huamarrjes), 'me shumë të ndryshueshme në periudha të ndryshme' (36% e rasteve të huamarrjes) dhe me 'një shumë të vetme në fund të periudhës' (15% e rasteve të huamarrjes). Gjatë gjashtëmujorit në analizë, vihet re një rënie në terma 6-mujorë dhe vjetorë (respektivisht me 1 pp dhe 5 pp) e peshës së huamarrjes që paguhet rregullisht me shuma të njëjta (ose të ndryshueshme) çdo muaj, tipike e kredimarrjes bankare afatgjatë (si p.sh. kredimarrja për blerje shtëpie ose zhvillim biznesi). Nga ana tjetër, pesha e rasteve të huamarrjes që shlyhet me shuma të ndryshme në periudha të ndryshme, karakteristikë e huave joformale apo huave bankare afatshkurtra (si overdraft, kartë krediti etj), ka rezultuar në rritje me 2 pp në terma 6-mujorë dhe me 8 pp në terma vjetorë.

**Grafik 2.6 - Huamarrja sipas MËNYRAVE TË PAGESËS.**

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket ngarkesës së huasë ndaj të ardhurave të familjeve huamarrëse, rezulton se rreth 71% e tyre deklarojnë se kjo pagesë zë më pak se 30% të të ardhurave mujore ('deri në 10% të të ardhurave' për 29% të familjeve huamarrëse, '10-30% të të ardhurave' për 42% të familjeve). Nga ana tjetër, rreth 29% të familjeve deklarojnë se kjo pagesë e tejkalon 30% të të ardhurave ('31-50% të të ardhurave' për 18% të familjeve, '51-70' për 7% të familjeve dhe 'mbi 70%' për 4% të familjeve).

**Grafik 2.7 - Huamarrja sipas raportit 'kësti huasë/të ardhurat totale mujore'.**

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.6-Afati i mbetur deri në maturim.** Në 72% të rasteve të huamarrjes deklarohet se huaja maturohet 'brenda një viti' dhe kjo peshë është rritur me 5 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 9 pp krahasuar me një vit më parë; në 25% të rasteve, afati i mbetur është '1-5 vjet' (në rënie me 3 pp dhe 7pp

krahasuar respektivisht me 6MII 2021 dhe me 6MI 2021) dhe në 3% të rasteve ka rezultuar 'mbi 5 vjet' (në rënie 1 pp dhe 2 pp krahasuar respektivisht me 6MII 2021).

### Grafik 2.8- Huamarrja sipas MATURIMIT TË MBETUR të huasë.

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.7-Garantimi i huamarrjes.** Në 70% të rasteve të huamarrjes rezulton se huaja është 'e pa garantuar' dhe kjo peshë është rritur me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por ka rënë me 4 pp krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga ana tjetër, pesha e rasteve të huamarrjes së garantuar 'me një pronë të familjes' ka mbetur e pandryshuar në terma gjashtëmujore dhe ka rezultuar në rritje me 1 pp në terma vjetore.

### Grafik 2.9 Huamarrja sipas FORMAVE TË GARANTIMIT të huasë.

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Zëri "tjetër" përmbledh rastet e huamarrjes së garantuar me forma të tjera, ku më shpesh përmendet garantimi i huasë përmes pagës, garantimi me një mall (si makina) etj.

## 3- Ngarkesa në borxh e familjeve

Në këtë seksion pyetjesh, familjeve huamarrëse u kërkohet të japin informacion vetëm për huanë më të madhe ekzistuese dhe që rëndon më shumë mbi ekonominë e familjes. Si rrjedhojë, peshat e përgjigjeve janë llogaritur mbi totalin e familjeve huamarrëse të përgjigjura për secilën pyetje.

**3.1-Ndryshimi i këstit.** Rreth 76% e familjeve huamarrëse të përgjigjura kanë deklaruar se kësti i huasë ka mbetur i pandryshuar gjatë 6-mujorit referues dhe kjo peshë është rritur me 2 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar. *Balanca neto* e përgjigjeve të pjesës tjetër të familjeve huamarrëse (24% e familjeve huamarrëse) ka rezultuar 3.3 pp, në rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por gjithsesi mbi vlerat e një viti më parë.


**Grafik 3.1 Ndryshimi i këstit mujor të huasë në 6 muajt e kaluar.**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**3.2-Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar dhe pritshmëritë për 6 muajt e ardhshëm.** Rreth 51% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese 'nuk ka ndryshuar' gjatë gjashtëmujorit të parë të 2022 dhe kjo peshë ka mbetur pothuaj e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, por ka rezultuar në rënie me 6 pp krahasuar me një vit më parë. Pjesa tjetër e të përgjigjurve, vlerësojnë në agregat *përkeqësim të aftësisë së tyre paguese* (43% kanë deklaruar 'përkeqësim' dhe 7% kanë deklaruar 'përmirësim') (Grafik 3.2), por në përmirësim krahasuar me rezultatet e vrojtimit të kaluar. Kjo është reflektuar në një përmirësim të pritjeve të familjeve lidhur me aftësinë e tyre paguese për gjysmën e dytë të vitit. Kështu, rreth 61% e familjeve huamarrëse nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese për gjysmën e dytë të vitit 2022, ndërsa balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar [- 19.3] pp, duke sugjeruar për pritje më optimiste krahasuar me rezultatet e gjashtëmujorit të kaluar dhe të një viti më parë. (Grafik 3.3).

**Grafik 3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar.** **Grafik 3.3 Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm.**



Burimi: Banka e Shqipërisë


**3.3-Pritshmëritë mbi marrjen e një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm**<sup>8</sup>. Rreth 53% e të përgjigjurve kanë deklaruar se 'nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm', ndërsa rreth 47% e tyre (ose 504 familje),

<sup>8</sup> Pyetja i drejtohet të gjithë kampionit prej 1210 familjesh dhe asaj i janë përgjigjur 1083 familje ose rreth 90% e totalit të kampionit.

deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie<sup>9</sup> mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re dhe kjo peshë është rritur me 2 pp krahasuar me gjashtëmujorin kaluar dhe me 6.2 pp krahasuar me një vit më parë. Duke analizuar vetëm grupin e familjeve që *planifikojnë të marrin një hua të re (486 familje)*, rezulton se rreth 59% e tyre janë *'huamarrës të rinj'*, pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit dhe kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtë muaj më parë, por ka rënë me 4 pp krahasuar me një vit më parë.

Si rezultat i shpërndarjeve të mësipërme, *indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re*<sup>10</sup> ka rezultuar 0.201, duke mbetur pothuaj në të njëjtin nivel me periudhën e kaluar, gjë që mund të sinjalizojë një moderim të kërkesës së individëve për kredi në gjysmën e dytë të vitit 2022. Gjithsesi zhvillimet e ardhshme të kërkesës së individëve për kredi, pritet të ndikohen nga zhvillimet në arenën ndërkombëtare dhe shpejtësia e normalizimit të politikës monetare në vend.

### Grafik 3.4 Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm dhe Indeksi i planifikimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 4- Pasuria e familjeve

Kjo rubrikë përmban vetëm 2 pyetje mbi pronat e patundshme dhe pasurinë financiare të familjeve të intervistuar dhe i drejtohet të gjithë kampionit të familjeve. Rezultatet për 6-mujorin e parë të vitit 2022, paraqiten si më poshtë:

**4.1-Pasuritë e patundshme të familjeve.** Për këtë seksion pyetjesh kanë dhënë përgjigje 1083 familje, nga të cilat 95% kanë deklaruar se zotërojnë të paktën një pronë të patundshme. Familjet e përgjigjura deklarojnë se zotërojnë në total *1542 prona të patundshme të llojeve të ndryshme* ku: 93% e tyre (1006 familje) zotërojnë *'1-2 prona të patundshme'* kryesisht të llojit *'shtëpi banimi'* ose kombinim i një shtëpie banimi dhe një prone tjetër si *'tokë', 'dyqan', 'godinë'* etj. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar, dhe ka rënë me 1 pp krahasuar me një vit më parë (Grafik 4.1). Nga ana tjetër, 2% deklarojnë se zotërojnë *'më shumë se 2 prona të patundshme'*, (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.), ndërsa 5% kanë deklaruar se *'nuk zotërojnë asnjë pronë'*.


<sup>9</sup> Alternativat e dhëna janë: 'ka pak mundësi', 'ka shumë mundësi' dhe 'është e sigurt'.

<sup>10</sup> Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e % së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientet përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në 4 nën-intervale me gjatësi të barabartë 0.33. Koeficientët për secilën alternativë rezultojnë: 0 ('nuk ka asnjë mundësi'), 0.33 ('ka pak mundësi'), 0.66 ('ka shumë mundësi') dhe 1 ('është e sigurt'). Indeksi i përfutur merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.


Duke e fokusuar analizën vetëm në grupin e **familjeve huamarrëse** (gjithsej 240 familje huamarrëse), rezultojnë këto familje deklarojnë gjithsej 352 prona të patundshme, ku 69% e tyre janë 'shtëpi', 28% janë 'toka' dhe pjesa tjetër janë 'dyqane' dhe 'godina' dhe lloje të tjera pronash.

Në shpërndarjen e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë, rezultojnë se: rreth 92% e tyre (221 familje) zotërojnë '1-2 prona të patundshme' në momentin e intervistimit, dhe kjo peshë është rritur me 1 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar. Në shumicën e rasteve këto prona janë një shtëpi banimi ose kombinimi i një shtëpie dhe një sipërfaqe toke. Vetëm 2% e familjeve huamarrëse (5 familje) deklarojnë se zotërojnë 'më shumë se dy prona' dhe kjo peshë ka rënë me 1 pp krahasuar me vrojtimin e 6-mujorin e kaluar, ndërkohë që rreth 6% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se 'nuk zotërojnë asnjë pronë' (Grafik 4.2).

**Grafik 4.1 Shpërndarja e familjeve (totali i kampionit) sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura).**



**Grafik 4.2 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura).**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**4.2-Pasuritë financiare të familjeve**<sup>11</sup>. Nga përgjigjet e dhëna, rezultojnë se për periudhën e vrojtuar, 52% e totalit të familjeve të kampionit të vrojtuar (huamarrëse dhe jo-huamarrëse) dhe 73% e grupit të familjeve huamarrëse, deklarojnë se 'nuk zotërojnë asnjë lloj pasurie financiare' dhe të dyja këto peshë janë rritur respektivisht me 6 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.


Duke analizuar vetëm pjesën e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare të formave të ndryshme (duke përjashtuar rastet që 'nuk kanë asnjë lloj pasurie financiare'), rezultojnë se 'depozitat dhe/ose llogaritë bankare' vijojnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të kampionit të familjeve (56% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (51% e rasteve të raportuara). Krahasuar me 6-mujorin e kaluar, këto peshë kanë rënë me 4 pp në rastin e totalit të kampionit, dhe me 14 pp në rastin e familjeve huamarrëse.

<sup>11</sup> Pyetjes mbi pasuritë e financiare në pronësi të familjeve të intervistuar i janë përgjigjur 1088 familje.

**Grafik 4.3 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)**



**Grafik 4.4 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përdorimi i formave të tjera të investimit, të përmbledhura në termin *'investime të tjera'*<sup>12</sup>, ka rezultuar në një rritje të lehtë (me 1 pp) krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar në rastin e totalit të kampionit të vrojtuar dhe në rënie (me 3 pp) në rastin e grupit të familjeve huamarrëse. Nga ana tjetër, gjatë periudhës vihet re një rritje e rasteve të raportuara të mbajtjes në kursimeve në formë *cash-i* (jashtë banke), si në totalin e kampionit dhe në grupin e familjeve huamarrëse.

<sup>12</sup> Në zërin "Investime të tjera" përmblidhen rastet e investimeve në: bono thesari, sigurim jete, fond pensioni privat dhe aksione.